



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 944/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Edolina Plaqiqi nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Drenas, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.944/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Edolina Plaqiqi nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Drenas, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave. në qendrat e votimit 0322e në Qikatov e Re, 0321e Kishnarek, 0317e Llapushnik, 0306e Tërstenik, 0308e Baic, 0310e Nekoc, 0301e shkolla Rasim Kiqina, 0326e Shtuticë, 0323e Tërdevc.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Edolina Plaqiqi nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Drenas, me të cilën dyshon se për mos numërimin e saktë të votës nga ana e kryesuesve të klasave që kanë ndodhur brenda kutive votuese për parashtruesen e apelit me nr. 6. E njëjta kërkon rinumërim të votave në shkollat e cekuar si me poshtë 0322e në Qikatov e Re, 0321e Kishnarek, 0317e Llapushnik, 0306e Tërstenik, 0308e Baic, 0310e Nekoc, 0301e shkolla Rasim Kiqina, 0326e Shtuticë, 0323e Tërdevc.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga kandidatja për anëtar të Kuvendit Komunal në Drenas, Edolina Plakiqi nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Drenas, me të cilën kërkon rinumërim të votave është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saja, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apelueses nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidaten në fjalë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.944/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.